



# AWESK

SHOQATA E GRAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË NË KOSOVË  
ASSOCIATION OF WOMEN IN THE ENERGY SECTOR OF KOSOVO

# Powerful

Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë (AWESK) është krijuar si rezultat i rrjetit të mentorimit mCircle të krijuar në vitin 2016 për gratë në institucionet e sektorit të energjisë në Kosovë. AWESK u lansua publikisht në qershor të vitit 2017 me mbështetjen e projektit të USAID "REPOWER-KOSOVO" dhe është organizata e parë dhe e vetme e shoqërisë civile në Kosovë që fokusohet në çështjen gjinore në sektorin e energjisë.

Deri më tani, AWESK ka mbi 140 anëtare profesioniste të trajnuara dhe të arsimuara nga një gamë e gjerë profilesh, duke përfshirë: gra inxhinierë, teknologji informacioni, eksperte ligjore, personel i burimeve njerëzore, marketing dhe marrëdhënie me publikun dhe në fushën akademike të inxhinierisë dhe shkencave shoqërore.

Qëllimi i AWESK është të avancojë diversitetin gjinor përmes mentorimit, rrjetizimit, zhvillimit të aftësive dhe vetë-menaxhimit të karrierës. Ajo synon të ndihmojë institucionet të identifikojnë veprime konkrete dhe të zbatueshme që do të fuqizojnë gratë në industrinë e energjisë për zhvillim profesional.

## Parimet e AWESK

### PËRKUSHTIMI



Anëtarët e AWESK janë të angazhuara të realizojnë misionin e shoqatës

### PËRFSHIRJA & BARAZIA



Anëtarët e AWESK janë të angazhuara për krijimin e një sektori gjithëpërfshirës të energjisë

### PËRKRAHJE



AWESK krijon qasje dhe mundësi të reja për përfshirjen dhe përparimin e grave në sektorin e energjisë

### TRANSPARENCA & LLOGARIDHËNIA



AWESK respekton transparencën dhe përgjegjshmërinë si bazë të integritetit profesional

## Misioni

Misioni i AWESK-ut është të fuqizojë gratë në sektorin e energjisë në Kosovë nëpërmjet zhvillimit profesional të karrierës, rrjeteve, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

## Vizioni

Vizioni i AWESK-ut është të përgjigjet drejtpërdrejtë në sfidat me të cilat ballafaqohen gratë në sektor, duke përfshirë nën-përfaqësimin në mjediset profesionale dhe akademike dhe mungesën e mbështetjes institucionale, duke shërbyer si një platformë për të promovuar hyrjen e grave në sektorin e energjisë dhe zhvillimin e tyre profesional.

## Energjitë e AWESK

Anëtare profesioniste dhe me arsim të lartë

Aftësia për të kryer trajnime dhe avokim

Gatishmëria për të zbatuar projekte

Lidhje të forta midis anëtarëve dhe institucioneve të energjisë

Të angazhuara për rritjen e anëtarësisë

Marrëdhënie të shëndosha me organizatat e shoqërisë civile

## Objektivat Strategjikë të AWESK

- Rritja e pjesëmarrjes në trajnime dhe rrjetizim për të kontribuar në avancimin në karrierë dhe mundësitë e vendimmarrjes për gratë në sektorin e energjisë.
- Rritja e vetëdijës mbi eficiencën e energjisë dhe masat e mbrojtjes së mjedisit për të kontribuar në mundësi për cilësi më të lartë të jetës dhe mirëqenies, veçanërisht për vajzat dhe gratë.
- Rritja e bashkëpunimit midis sektorëve të energjisë dhe arsimit, si një mjet për të rritur qasjen në mundësitë e punësimit dhe njohjen e konsideratave gjinore në fushën e energjisë.



### ANËTARËSIMI

Anëtarësohu dhe përfito nga mbështetja që shoqata u jep grave që hyjnë ose zhvillohen profesionalisht në sektorin e energjisë.



### DHURONI

Donacionet janë të rëndësishme për shoqatën tonë dhe ka disa metoda që mund të përdorni për të mbështetur aktivitetet që kontribuojnë në arritjen e misionit tonë.

 [AWESKosovo](#)  [AWESK Kosovo](#)  [AWESKosovo](#)  [AWESK info](#)  [info@awesk.org](mailto:info@awesk.org)  [www.awesk.org](http://www.awesk.org)

Përkrahur nga:

